

# **RAPORTI FINAL**

## **MBI PRANIMIN E KULLËS SË TRAFIKUT AJROR MEOBJEKTET PËRCJELLËSE**

Shtator 2014

## **Raporti dhe vërejtjet e komisionit vlerësues**

Duke u bazuar në vendimin e kryeshefit ekzekutiv të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – Kontrolli Ajror, datë 16.01.2014, ne jemi emëruar si komision i cili ka për detyrë të bëjë pranim/dorëzimin e objektit të kullës së trafikut ajror me objektet përcjellëse nga Partneriteti Publiko Privat (PPP) tek ANP “Adem Jashari”–Kontrolli Ajror. Komisioni pranimi ka këtë përbërje :

### **ANP “Adem Jashari”-Kontrolli Ajror**

1. Simpatik Selmanaj (SS)
2. Alban Sylaj (AS)
3. Bejtullah Rexhepi (BR)

Vlen të theksohet se kontribut të veçantë kanë ofruar edhe personeli teknik dhe operativ nga shërbimet gjegjëse të ANP “Adem Jashari” –Kontrolli Ajror si shërbimi Teknik, Kontrollit të trafikut ajror, shërbimi meteorologjik, i sigurimit etj.

Si bazë për vlerësimin e objektit në fjalë, bazuar në vendimin e lartpërmendur është marrë kontrata PPP-09-001-611 me theks të veçantë ANNEX-i 13 i kontratës pika 3.0/3.1.1/3.1.2, ku përshkruhen detajet që i përkasin objektit të kullës së trafikut ajror me objektet përcjellëse.

Si dokumente mbështetëse për vlerësimin e pranimi të kullës së trafikut ajror dhe objekteve përcjellëse kemi përdorur edhe :

-**FAA ORDER 6480.4A** – në të cilin bazohet edhe kontrata PPP-09-001-611(**Doc 1.**)

- **ICAO Doc. 9426 – Air Traffic Services Planning Manual** – Section 2, Chapter 2&3

-**Safety Assessment Report “New Tower and office space requirement in PIA and ATCS Division”** të datës 08.02.2008 (**Doc.2**), i krijuar nga ANP “Adem Jashari”. Ky dokument në mënyrë detaje përshkruan nevojat dhe standardet që duhet t'i plotësojnë kullat e trafikut ajror, dhe i cili dokument gjithmonë është në harmoni me standardet e ICAO-s dhe Eurocontrol, që duhet të plotësohen për raste të tilla dhe dokumenti,

- **“Operational Needs for Air Traffic Control Services”(Doc 3.)** - dokument i datës Nëntor 2012, i cili dokument përshkruan në mënyrë detale disa kërkesa shtesë që janë drejtuar kompanisë LIMAK në lidhje me objektin e kullës së trafikut ajror me objektet përcjellëse.

Me datë 27.01.2014 kemi bërë takimin e parë zyrtar në të cilin takim, ANP "Adem Jashari"-Kontrolli Ajror, është përfaqësuar nga komisioni vlerësues dhe ai mbeshtetës, PPP (Partneriteti Publiko Privat) ka qenë i përfaqësuar nga z. Donat Alaj (DA), dhe LIMAK ka qenë i përfaqësuar nga Esra Saygi dhe Alican Anay.

Në këtë takim janë njoftuar dhe prezantuar palët, si dhe qartësuar detyrat që i kemi me këtë rast. Në këtë takim nga LIMAK është dorëzuar pjesa grafike projektit gjeneral "AS-BUILT" i kullës së trafikut ajror me objektet përcjellëse, në një kopje në letër, dhe një kopje në CD. Kopja në CD përmbante versionin PDF dhe CAD.

Në këtë takim nga përfaqësuesi i PPP DA jemi njoftuar se për mbikëqyrjen dhe pranimin projektit të kullës dhe terminalit, PPP dhe Limak kanë kontraktuar një kompani spanjolle INECO e specializuar për punë të tilla, e cila ka pasë për detyrë të bëjë përcjelljen e punëve në të gjitha fazat e projektit, dhe të bëjë pranimin teknik të tyre.

Në këtë takim ne jemi pajtuar që të bëjmë një vizitë në objektin e kullës së trafikut ajror në mënyrë që së bashku t'i bëjmë inspektimet e nevojshme në objekt. Takimi është mbyllur dhe jemi pajtuar që takimin e radhës të mbajmë me datë 29 janar 2014.

Me datë 29 janar 2014 Komisioni (AL, SS, BR) i caktuar nga KE për pranimin e objektit të Kullës së Kontrollit dhe ekipi mbeshtetës (FZ, MI, IH), ishim për vizitë në këtë objekt, i shoqëruar nga përfaqësuesi i PPP - Donat Alaj, përfaqësues nga Limak Insat - arkitektja Esra Saygi dhe Alican Anay dhe përfaqësues nga firma inxhinierike mbikëqyrëse INECO.

Fillimisht u vizitua pjesa e ndërtesës ku janë hapësirat e zyrave dhe të pajisjeve teknike, poashtu edhe hapësira nën ndërtesë (bodrumi), e në fund edhe vetë Kulla e Kontrollit si dhe ndërtesa përbri ku do të vendosen gjeneratorët dhe ku tashmë është trafostacioni.

Duke u bazuar në kontratën e PPP-09-001-611, dokumentave përcjellëse të cekura me lartë në këtë raport, projektin e dorëzuar nga LIMAK "As Built" dhe inspektimeve të bëra në objekt, ne si komision vlerësues së bashku me ekipin mbeshtetës kemi listuar vërejtjet (shih ANEX 1 të këtij raporti) dhe i kemi dërguar personave përgjegjës të PPP, dhe LIMAK.

Me datë 03.02.2014 komisioni për pranimin e kullës së trafikut ajror ka bërë dërgimin e listës së përpiluar me vërejtjet e identifikuara në objekt tek përfaqësuesit e PPP dhe LIMAK.

Me datë 26.02.2014 kemi organizuar takimin e radhës në mes PPP përfaqësuesve të LIMAK dhe neve si komision. Në këtë takim janë bërë diskutime detale rreth vërejtjeve që ne si komision i kemi identifikuar (56 sosh), kurse me theks të veçantë janë diskutuar vërejtjet e bëra rreth furnizimit të panderprerë me energji (Gjeneratorë dhe UPS-et). LIMAK theksonte se vërejtjet e listuara nga ne, rreth energjisë janë përgjegjësi e ANP "Adem Jashari"-Kontrolli Ajror. Ne i kemi argumentuar vërejtjet e identifikuara rreth energjisë, duke u bazuar në kontratën

e PPP me Limak Annex 13 pika 5.1.4.A thuhet që: "Partneri privat duhet të sigurojë energji të pandërprerë dhe stabile dhe të besueshme 24/7 gjatë tërë vitit (365 ditë).

LIMAK me vonë është pajtuar që furnizimi me energji të pandërprerë i takon atyre, dhe ka angazhuar ekipin teknik të tyre që të diskutohet më tej rreth fuqisë së angazhuar në objekt, në mënyrë që të bëjë specifikat e gjeneratorit dhe UPS-ve. Gjatë këtyre takimeve jemi pajtuar që fuqia e gjeneratorit të jetë 500 KVA, kurse si gjenerator rezervë do të përdorim gjeneratorët e tyre nga ndertesa e MEP-it, në mënyrë manuale. Gjithashtu jemi pajtuar që të bëhet instalimi 2 UPS-ve me fuqi 60 KVA secili (në lidhje paralele) që do të vendoset në dhomen elektrike, si dhe i 2 UPS-ve me fuqi 60KVA secili (në lidhje paralele) që do të instalohet në dhomën e servereve.

Gjithashtu në këtë takim i kemi sqaruar edhe vërejtjet që kanë të bëjnë me sigurimin e objektit bazuar në standardet e MPB për objekte të tilla vitale të shtetit. Neve nga MPB kemi siguruar një dokument i cili e definonte formën e perimetrit që duhet të ketë objekti i kullës së trafikut ajror, dhe të njëjtin i kemi prezentuar palëve të PPP dhe LIMAK. Në ndërkohë LIMAK ka shqyrtuar këtë dokument dhe kemi pasur përgjigje pozitive, ku njëherit në takime kanë theksuar se një gjë e tillë do të realizohet sipas standardeve të përkrahura në këtë dokument.

Në listen e përpiluar të verjetjeve janë diskutuar edhe disa pika rreth kullës së kontrollit dhe pamjes së limituar të saj në një segment të TXW (Taxi Way), ku neve si komision se bashku me pjesën operative kemi theksuar se, në një segment të caktuar nuk mund të shihet TWY A, në pozicionin ulur të Kontrollorit të Trafikut Ajror. Kjo është vërtetuar edhe me simulimin e pozitës nga ana e kontrollorëve të trafikut ajror. Ne kemi theksuar që për të eliminuar këtë pengesë duhet të largohen dy brinjë të ballkonit të kullës. Një kërkesë e tillë nga LIMAK është konsideruar e mundshme por, nuk garantonin se me largimin e dy brinjëve të ballkonit përveç harmonisë së pamjes vizuale të kullës, mund të vijë edhe deri tek dëmtimi i sistemit të drenazhimit të kullës. Limak nuk garantonte që më prerjen e këtyre dy brinjëve të ballkonit mund të sigurohej një drenazhim i mirfilltë.

Në këtë takim janë diskutuar detalisht të gjitha pikat një nga një, dhe kemi theksuar se do të përcjellim kohën e implementimit të tyre.

Vlen të theksohet se LIMAK nuk definonte ndonjë afat rreth implementimit të këtyre pikave përkundrazi fakti që neve vazhdimisht kërkonim afate kohore të implementimit. Gjatë muajve, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht ne vazhdimisht kemi përcjellë implementimin e këtyre pikave, si dhe kemi pasur takime të nivelit teknik për formën e implementimit të tyre.

**Më poshtë do të pershkruajmë në formë detale verejtjet të cilat LIMAK i ka implementuar nga koha e pranimi të listes së verejtjeve deri tek implementimi i tyre:**

- LIMAK ka bërë instalimin e gjeneratorit me fuqi 500KVa, ka bërë pranimin teknik dhe trajnimin e stafit për mirembajtje, kjo punë është finalizuar me 23.06.2014;
- LIMAK ka bërë instalimin e 4 UPS-ve me fuqi 60KVa secili, ka bërë pranimin teknike dhe trajnimin e stafit për mirembajtje. Kjo është finalizuar me 21.08.2014;
- LIMAK ka implementuar rrethojen sipas standardeve të MPB, dhe ka instaluar dy dyer me hapje manual (në shina);
- LIMAK ka bërë implementimin e lidhjes rezervë të energjisë, me anën e së cilës objekti i ANP mund të kyçet në raste emergjente për furnizim me energji nga ndertesa e MEP-it;
- LIMAK ka bërë instalimin e një kamere në server room dhe ka dorëzuar një kamerë për nevojën të shërbimit meteorologjik (njihërit do të asistojë në instalimin e saj në objektin e kullës);
- LIMAK ka dorëzuar 50 copë converter OPTIC-RJ45 me anën e së cilës është bërë e mundur që të kalohet nga një medium optik i transmetimit në një medium Ethernet;
- LIMAK ka dorëzuar 2 "Network Switch" të menaxhueshëm për nevojën të rrjeteve tona;
- LIMAK ka bërë mbylljen e të gjitha vrimave në mënyrë që të bëjë parandalimin e hyrjes së brejtësve nëpër dhomat teknike dhe operative;
- LIMAK ka bërë pastrimin e të gjithë objektit dhe me theks të veçantë ka bërë pastrimin e dhomave me dyshe me ngritur;
- LIMAK ka bërë instalimin e tavanit të leshuar në dhomen e ACC/APP, dhe lysterjen e tij sipas standardeve, njihërit ka riinstaluar ndriçimin e nevojshëm për atë dhomë;
- LIMAK ka bërë instalimin e prizave UPS në dhomat që kanë qenë të parapara për shërbimin operativ meteorologjik;
- LIMAK ka bërë dorëzimin e servereve dhe klienteve për sistemin CCTV, Card Access si dhe njihërit ka bërë dorëzimin e manulave, dhe ka organizuar trajnimin për stafin operativ dhe teknik;
- LIMAK ka bërë instalimin e tokezimit të punës, i cili duhet të jetë i ndarë nga tokezimi mbrojtës;
- LIMAK ka bërë vendosjen e derës afer ashensorit që të shpjen tek kulla e kontrollit, njihërit ka bërë edhe instalimin e interfonit për kontroll të qasjes në këtë derë;
- LIMAK ka rishtresuar dhe ka perfunduar punët civile mbi çatinë e kullës, si dhe ka instaluar derën për qasje në çatinë e kullës. Vlen të theksohet se kjo derë menaxhohet në mënyrë automatike;
- LIMAK ka dorëzuar studimet e OLS-se, studimet gjellogjike, rezultatet e matjes së rezistencës së tokezimit të objektit, manualët e sistemeve të CCTV, Access control, Alarmit kundër zjarrit, HVAC-ut, pranimet teknike dhe manualët e gjeneratorëve dhe UPS-ve, ashensorit etj;

- LIMAK ka organizuar trajnimin teknik dhe operativ për sistemin: Alarmit kunder zjarrit, Acces Control, UPS, gjeneratorë, HVAC;
- LIMAK ka bërë nderrimin e xhamave të kullës, të cilat kanë qenë të krisura me parë;
- LIMAK ka finalizuar MOU-t për: pastrimin e përbashket të kullës niveli i parë, qasjen e përbashket të derës në bodrumin e kullës që shpie në terminal, harxhimet e HVAC-ut, harxhimet e rrymes në rast se ne perdorim në raste emergjente gjeneratorët nga ndërtesa e MEP-it;
- Prerja e dy brinjëve të kullës, LIMAK ka theksuar se do të bëjë një gjë të tillë, mirëpo ka shfaqur dyshime rreth sistemit të drenazhimit në të ardhmen. Ne si komision kemi pasur një takim me pjesën operacionale të stafit si dhe asaj menaxheriale (takim i zhvilluar më 05.08.2014) ku është vendosur që ballkoni i kullës të mos preket.
- LIMAK ka dorëzuar të gjitha testimet e kablove të komunikimit optik dhe ETHERNET që rezultojn brenda parametrave, si dhe ka dorëzuar edhe atestet e kablove dhe paneleve energjetik të instaluar në objekt.
- LIMAK ka dorëzuar “AS BUILD” projektin e kullës me objektet percjellëse në “Hard & soft copy”

**Pikat të cilat LIMAK nuk i ka implementuar dhe të cilat i ka konsideruar si përgjegjësi e ANP “Adem Jashari”- Kontrolli Ajror:**

- LIMAK ka theksuar se furnizimi me “Rack Cabinets” nuk është përgjegjësi e tyre (pika 8 Annex 1)
- LIMAK ka theksuar se konsollat për dhomen monitoruese teknike nuk është përgjegjësi e tyre (pika 15 Anex 1)
- LIMAK ka theksuar se instalimi i shkalleve spirale për nevoja të shërbimit meteorologjik nuk është përgjegjësi e tyre (pika 19 Annex 1)
- LIMAK ka theksuar se mbyllja e zyrës së asistentes që ndodhet në koridor nuk është përgjegjësi e tyre (pika 37 Annex 1)
- LIMAK ka theksuar se instalimi në hyrje të objektit të sistemit X-RAY nuk është përgjegjësi e tyre (pika 39 Annex 1)
- LIMAK ka theksuar se sistemi për hapje të teledirigjuar të portes nuk është përgjegjësi e tyre (pika 51 Annex 1)
- LIMAK ka theksuar se ndërtimi i një kthine në hyrje të objektit për nevoja të sigurimit nuk është përgjegjësi e tyre (pika 52 Annex 1)

**Duke pas parasysh faktin që shërbimet operative duhet modeomos të jenë të furnizuara nga rrjeti energjetik i pandërprerë (UPS), nuk ka pasur mundësi që ANP “Adem Jashari “- Kontrolli Ajror të fillojë me rilokimin e shërbimeve operative dhe administratës. Pas instalimit të UPS-ve dhe komisionimit të tyre me date 21.08.2014, ANP “Adem Jashari”-Kontrolli Ajror ka bërë përgatitjet e nevojshme për të filluar fazën e rilokimit nga objektet e vjetra në të reja. Kështu në fillim të shtatorit 2014 ka filluar rilokimi i shërbimeve të administratës, duke pasuar më vonë me rilokim e shërbimeve operative të meteorologjisë (datë 03.09.2014) dhe AIS (datë 05.09.2014).**

Vlen të theksohet se me datë 8.09.2014 unë si kryesues i komisionit për praninë të kullës me objektet percjellëse, kam pranuar nga personat përgjegjës të LIMAK z.Alican Ankay të gjithë çelësat e objektit dhe i kam dorëzuar tek shërbimi i sigurimit të ANP”Adem Jashari” - Kontrolli Ajror.

Me poshtë në ANNEX 1 i kemi të përshkruar në detale të gjitha vërejtjet e listuara nga ne si komision, si dhe statusi i tyre përfundimtar.

**ANNEX 1**

**LISTA E VËREJTJEVE**



#	Lokacioni	Evidentimi gjatë inspektimit	Implementimi	Statusi
1	Shtëpiza e transformatorit dhe gjeneratorit	Nuk ka gjeneratorë. Duhet të instalohen dy gjeneratorë Main/Stby, me pjeset përcjellëse si ATS (Automatic transfer switch) etj.	Eshtë instaluar gjeneratori me fuqi 500 KVA, është testuar dhe komisionuar. Në kompensim të asaj që të kemi dy gjeneratore LIMAK ka ofruar lidhjen nga gjeneroret e tyre në ndertesen MEP-it, të cilat mund të përdoren në mënyrë manuale në rast se gjeneratori i ANSP-se është defekt. Gjithashtu është në finalizim nënshkrimi i një MOU-je nga shërbimet gjegjëse për përdorimin e gjeneratorit të LIMAK në ndertesen e MEP –it në raste emergjente.	“CLOSED”
2	Shtëpiza e transformatorit dhe gjeneratorit	Gjatë inspektimit është vërejtur se është instaluar tanku i derivatëve, por temperatura e operimit të tij është deri në -20 grad, gjë që është e papranueshme sepse temperaturat në ANP janë regjistruar deri në -29 grad Celsius. Duhet të shihet mundësia e izolimit të tankut në mënyrë që të durojë temperatura më të ulët të operimit.	LIMAK ka siguruar se derivateve të naftës në Tank duhet të shtohet një sasi aditivi që shërben kundër ngrirjes së derivateve në Tank.	“CLOSED”
3	Shtëpiza e transformatorit dhe gjeneratorit	Nga vizatimet e projektit (“As built”) që kemi pranuar nga PPP dhe Limak, shihet që në kthinën ku planifikohet të instalohet gjeneratori, ka vend vetëm për një gjeneratë, kurse kërkesat tona operative kërkojnë të jenë dy gjeneratë, edhe pse në fillim të projektit në disa takime që kemi pasur si ANP me përfqasuesit e LIMAK, na është bërë me dije se furnizimi me energji do të vijë nga ndertesa e MEP-gjë që me vonë ka ndërruar pa paralajmrim.	Eshtë instaluar gjeneratori me fuqi 500 KVA, është testuar dhe komisionuar. Në kompensim të asaj që të kemi dy gjeneratore LIMAK ka ofruar lidhjen nga gjeneroret e tyre në ndertesen MEP-it, të cilat mund të përdoren në mënyrë manuale në rast se gjeneratori i ANSP-se është defekt. Gjithashtu është në finalizim nënshkrimi i një MOU-je nga shërbimet gjegjëse për përdorimin e gjeneratorit të LIMAK në ndertesen e MEP –it në raste emergjente.	“CLOSED”

4	Dhoma elektrike ATC-011	Nga pjesa e grafike e projektit te kullës te dorezuar nga LIMAK, verehet se në dhomen elektrike janë prezent dy UPS, kurse ne te vertet UPS-et mungojn ne kete dhome. Infrastruktura kabllorike për dy UPS është prezente.	LIMAK ne fillim ka theksuar se furnizimi me UPS nuk është detyrim i tyre, por pas disa takimeve qe kemi pasur ata kane nderruar qendrim dhe është bere instalimi i dy UPS-ve me kapacitet 60KVa secili ne “parallel Mode” .Ne kete menyre është bere instalimi, komisionimi,dhe trajnimi i stafit. Vlen te theksohet se dy UPS-et e vendosur ne kete dhome, furnizojn zyrtar operative te Meterologjise, AIS,Ramp Tower .	“CLOSED”
5	Dhoma elektrike në “Ramp tower”	Sipas projektit të dorëzuar shihet se në dhomen elektrike të “Ramp Tower” është instaluar infrastruktura kabllorike për dy UPS (60KVa secili),mirepo UPS-et në këtë dhomë mungojn	LIMAK ne fillim ka theksuar se furnizimi me UPS nuk është detyrim i tyre, por pas disa takimeve qe kemi pasur ata kane nderruar qendrim dhe është bere instalimi i dy UPS-ve me kapacitet 60KVa secili ne “parallel Mode” .Ne kete menyre është bere instalimi, komisionimi,dhe trajnimi i stafit. Vlen te theksohet se dy UPS-et e vendosur ne kete dhome, furnizojn dhomen e serverit dhe dhomen teknike monitoruese .	“CLOSED”
6	Dhoma e hapsires sistemore – server EQ-ATC-022	Mungon pamja vizuale nga dhoma monitoruese në server room.	LIMAK ka bere instalimin e kesaj kamere ashtu siq jemi dakorduar.	“CLOSED”
7	Dhoma e hapsires sistemore – server EQ-ATC-022	Mungojn dyer me dy kapak, që nevojiten në rastet kur instalohen pajisje të cilat i tejkalojn përmasat e derës aktuale.	Limak ka theksuar se neper deren aktuale mund te futet qfardo kabineti i permasave standarde qe nevojiten per vendosjen e pajisjeve operative,dhe nuk ka nevojte per nje detyre te tille.	“CLOSED”
8	Dhoma e hapsires sistemore – server EQ-ATC-	Mungojn “Rack cabinets” me aksesoret përkatës (“Power strips”,“Fan Coiler etj.) për akomodimin e kabllorëve,	LIMAK ka theksuar se “Rack Cabinets “ është pergjegjjesi e ANSP-se.	

	022	"switchave" dhe sistemeve të rilokuara të ATC-se.		"CLOSED"
9	Dhoma e hapsires sistemore – server EQ-ATC-022	Infrastruktura optike nga dhoma e serverit drejt kullës, objektit të vjetër të ATC-së, dhe dhomes së komunikimeve ATC-020, duhet të përfundon në Ethernet në të dy skajet (përmes konverteve adekuat OPTIC-ETHERNET)	LIMAK ka dorezuar konverteret e nevojshem për konvertimin e mediumit nga optic në LAN.	"CLOSED"
10	Dhoma e hapsires sistemore – server EQ-ATC-022	Bazuar në planin e rilokimit, në mënyrë që tërë sistemet të bëhen operative nevojiten të instalohen "Network switch"-a për secilin sistem.	LIMAK ka dorezuar vetëm dy "Network Switch" të menagjueshem, dhe kanë theksuar se kjo është përgjegjësi e plote ANSP.	"CLOSED"
11	Dhoma e hapsires sistemore – server EQ-ATC-022	Hapsirat në dhomat ku ka dysheme të ngritur duhet të pastrohet pjesa nën dysheme, pasi që këto hapsira nuk janë pastruar fare dhe gjithmonë paraqesin rrezik për pajisjet elektronike, që do të operojnë në këtë dhomë.	LIMAK ka bërë pastrimin e të gjitha lokacioneve me dysheme të ngritur	"CLOSED"
12	ATC-Bodrumi	Të gjitha vrimat që ekzistojnë për kalimin e kablove nga një lokacion në lokacionin tjetër përmes bodrumit, duhet të izolohen në atë mënyrë që të parandalohen futjet e brejtësve	LIMAK ka bërë mbylljen e të gjitha vrimave që do të jenë pengese për futjen e brejtësve	"CLOSED"
13	Dhoma e hapsires sistemore – server EQ-ATC-022	Tavani i kësaj dhome duhet të mbulohet me tavan të leshuar (Armstrong) në mënyrë që të mos shihen gypat e ngrohjes dhe instalimet e ndriqimit.	Jemi dakorduar që kjo dhomë të mos mbyllet me tavan të leshuar.	"CLOSED"
14	Dhoma monitoruese EQ-ATC-022	Tavani i kësaj dhome duhet të mbulohet me tavan të leshuar (Armstrong) në mënyrë që të mos shihen	Jemi dakorduar që kjo dhomë të mos mbyllet me tavan të leshuar	"CLOSED"

		gypat e ngrohjes dhe instalimet e ndriqimit.		
15	Dhoma monitoruese EQ-ATC-022	Në dhomen monitoruese mungojnë konzollat për vendosjen e PC-ve monitoruese të sistemeve të ATC-së	LIMAK ka theksuar se kjo është pergjegjesi e ANSP-se	“CLOSED”
16	ATC-ACC-021 Qendra e kontrollit radarik	Salla APP nuk ka fare tavan të leshuar (ang. false ceiling), në sallë shihet gjithë instalimi i instaluar në tavan. Poashtu ka shumë ndricim natyral që nuk mund të kontrollohet, duhet të vendosen roleta për kontrollimin e ndricimit natyral, sidomos duke e ditur që ajo sallë dritaret i ka në drejtim të Lindjes dhe Dielli është shumë i ulët në mengjes që mund të paraqesë problem me reflektim në ekranat e Radarit.	LIMAK ka bërë instalimin e tavanit të leshuar, është bërë ngjyrosja e tavanit sipas kërkesave të kontrolloreve të trafikut ajror, si dhe është riinstaluar ndriqimi i komplet i dhomes. Kurse vendosja e perdeve për kontrollimin e ndriqimit kanë theksuar se është pergjegjesi e ANSP-se.	“CLOSED”
17	ATC-ACC-021 Qendra e kontrollit radarik	Paneli elektrik i vendosur në këtë dhomë duhet të këtë dy furnizime të ndara, një nga UPS-i dhe tjetri nga rrjeti elektrik komercial. Nga inspektimi është vërejtur se ekziston vetëm paneli i UPS-it, kurse paneli i rrjetit elektrik komercial mungon. Gjithashtu shpërndarja e rrjetit elektrik (prizave) në dhomë për këtë panel mungon.	Jemi pajtuar që në këto pike most e këto fare ndryshime, por të mbetet ashtu siq është aktualisht.	“CLOSED”
18	Meteo/ Ais ATC -12,13,14,15,16	Gjatë observimit të këtyre hapsirave është vërejtur se mungon paneli elektrik në UPS, gjë që është paraparë të jenë dy panele elektrike, njëri për furnizim nga UPS-i, kurse tjetri nga rrjeti elektrik komercial. Në dhomen ATC 017 vërehet se janë instaluar prizat për UPS, kurse në	Jemi pajtuar që në për dhomen ATC-017 të mos këto fare ndryshime, por të mbetet ashtu siq është aktualisht, kurse për zyret e meteorologjise që nuk kanë pasur prizat UPS LIMAK ka bërë instalimin e prizave dhe infrastruktures kabllorike elektrike nga UPS qendror deri tek prizat në dhomat e	“CLOSED”

		dhomat tjera nuk ka prizë me UPS .Kjo duhet të jetë në harmoni me kerkesat operative të kerkuara.	meterologjise.	
19	Meteo ATC - 12, 13	Meteorologet duhet të kenë qasje në oborrin e ndertesës për qellim të kryerjes së shërbimit me të cilin janë të ngarkuar, observimit të motit. Duke e parë që nuk ka mundësi të realizimit të detyrës në zyren e tyre, atëhere mbetet që dera emergjente në pjesën veriore të ndertesës të shërbejë për personelin MET që të hyjnë/dalin nga objekti sipas nevojës. Poashtu duhet të montohen shkallë metalike që u mundësojnë MET që të ngjiten në kulmin e ndertesës, për të parë aeroportin dhe rrethinën me qellim të observimit të motit në mënyrë sa më objektive.	LIMAK ne fillim është pajtuar që të vendosë një lloj shkalle spirale, dhe kanë ofruar një model të shkalleve, por në ndërkohë është refuzuar duke theksuar se kjo është përgjegjësi e ANSP-se.	“CLOSED”
20	Alarmi kundër zjarrit dhe shuarsi automatik i zjarrit	Duhet të ofrohen manualët e prodhuesit, pranimet teknike, si dhe të bëhet trajnimi i stafit për mirëmbajtje dhe operim.	LIMAK ka dorëzuar materialet e sistemit të alarmit kundër zjarrit , dhe ka bërë trajnimin teknik dhe operative të stafit për këtë sistem.	“CLOSED”
21	Master Clock	Është vërejtur se “display të “master clock” janë prezente vetëm në “Ramp Tower” dhe i paraqitur vetëm me ore dhe minuta .Keta display duhet të shpërndahen edhe nëpër dhoma tjera operative si EQ-ATC-022,. Meteo/ Ais ATC -	LIMAK ka theksuar se kjo ore është një ore normale që tregon kohën e rëndomt dhe nuk është e lidhur me ndonjë sistem GPS, që do të shfrytëzohej si ore operative .	“CLOSED”

		12,13,14,15,16 dhe ATC-ACC-021 Duhet të ofrohen manualet e prodhuesit,pranimet teknike, si dhe të bëhet trajnimi i stafit për mirembajtje dhe operim.		
22	HVAC	Duhet të ofrohen manualet e prodhuesit,pranimet teknike, si dhe të bëhet trajnimi i stafit për mirembajtje dhe operim.	Manualet dhe pranimet teknike te sistemit HVAC jane dorezuar, dhe eshte bere trajnimi I stafit teknik	“CLOSED”
23	HVAC	Gjatë observimit jemi njoftuar se ngrohja dhe ventilimi është qendror dhe vjen nga ndertësa e MEP-it.Ne në objekt të ATC e kemi të instaluar një Substacion nga ku bëhet edhe matja e hargjimeve tona.Ne me LIMAK duhet të bejm një marveshje rreth ketyre sherbimeve .Gjithashtu jemi njoftuar se e tërë pjesa e HVAC-ut që gjindet në hapsirat tona duhet të mirembahet nga ne duke përfshire edhe pjeset rezerv. Duhet të na ipet lista e pjesëve rezerv, dhe të përpilohet marrveshja në lidhje me këtë sherbim mes ANP dhe LIMAK	Ne lidhje me hargjimet e HVAC-ut qe LIMAK furnizon ANSP nga sistemi qendror eshte ne finalizim nenshkrimi i MOU-s nga sherbimet gjegjese .	“CLOSED”
24	HVAC	Radiatorët pranë dritareve që të gjithë ishin të mbuluar me një mbulesë. Akordimi i rregullatorit të temperaturës duket të jetë paksa problematik, duke qenë se duhet të largohet mbulesa në pjesën e sipërme për t’iu qasur valvolës për akordim.	LIMAK ka theksuar se nuk ka mundësi tjetër të nderhyrjes përpos asaj që kanë ofruar.	“CLOSED”
25	HVAC	Në shumicën e radiatorëve gypat përfundimtar (vertikalet) ishin të vedosura në menyrë joprecize.	LIMAK ka arsyetuar se për shkak të trajteve, nuk ka mundur që të devijon disa gypa të ngrohjes,dhe nuk ka mundësi të	“CLOSED”

			ndryshimit te kahjes se tyre.	
26	CCTV	Duhet të ofrohen manualët e prodhuesit, pranimet teknike, si dhe të bëhet trajnimi i stafit për mirembajtje dhe operim.	LIMAK ka dorëzuar materialin për sistemin e CCTV, si dhe ka bërë trajnimin e stafit teknik operativ të ANSP	“CLOSED”
27	CCTV	Mungojn sistemi për operatorë (PC me monitor) për survejim të objektit të ANSP	Gjate inspektimit është vërejtur se ekzistojnë serveret dhe klientet për survejim të objektit	“CLOSED”
28	Rrufepritësi dhe Tokezimi	Duhet të ofrohen testimet e nevojshme sipas standardeve në fuqi (lokale dhe ndërkombetare ), për tërë objektin, si matja e rezistencës së tokezimit dhe rrufepritësit.	LIMAK ka dorëzuar raportet e nevojshme të testimeve të tokezimit dhe rrufepritesit.	“CLOSED”
29	Tokëzimi mbrojtës dhe i punës në EQ-ATC-022	Tokezimi i punës në server room duhet të jetë i ndarë nga tokëzimi mbrojtës. Duhet të sigurohet që në dhomen e serverit ekziston një kolektore i tokezimit të punës dhe i cili është independent nga tokezimi mbrojtës.	LIMAK ka bërë instalimin e tokezimit mbrojtës dhe të punës.	“CLOSED”
30	Studimet gjeologjike dhe statike	Duhet të ofrohet dokumentacioni i nevojshëm sipas standardeve për studimet gjeologjike dhe statike	LIMAK ka dorëzuar “soft Copy” studimet gjeologjike dhe statike	“CLOSED”
31	Infrastruktura optike	Duhet të ofrohen testimet e nevojshme për infrastrukturën e komunikimeve optike, sipas standardeve në fuqi, në mënyrë që të sigurohem që humbjet në kabllo të shtrira dhe të tjerë optike janë brenda limitëve të lejuara	LIMAK ka dorëzuar testimet e të gjitha kabllove optike, të cilat rezultojnë se janë brenda parametërve standard.	“CLOSED”
32	Infrastruktura	Duhet të ofrohen testimet e	LIMAK ka dorëzuar testimet e të	

	Ethernet	nevojshme për infrastrukturen e komunikimeve STP/UTP, sipas standardeve në fuqi, në mënyrë që të sigurohemi që humbjet në kabllot e shtrira dhe të tërminuara janë brenda limitëve të lejuara	gjitha kabllove STP/UTP, të cilat rezultojn se janë brenda parametrave standard.	“CLOSED”
33	Infrastruktura e komunikimeve të bakrit	Duhet të ofrohen testimet e nevojshme për infrastrukturen e komunikimeve baker, sipas standardeve në fuqi, në mënyrë që të sigurohemi që humbjet në kabllot e shtrira dhe të tërminuara otike janë brenda limitëve të lejuara	LIMAK ka dorezuar testimet e të gjitha kabllove të komunikimeve të bakrit, të cilat kanë rezultuar brenda parametrave standard	“CLOSED”
34	Studimet e OLS	Duhet të ofrohet dokumenti që e verifikon se kulla me gjatësi sipas projektit nuk paraqet pengesë operative. Duhet të ofrohen të dhëna se deri në cilën lartësi mund të instalojmë antenat e nevojshme për operim mbi kulmin e kullës	LIMAK ka dorezuar studimet e OLS-se	“CLOSED”
35	Sigurimi	Dera që kufizon qasjen në kanal dhe kabllimit në nivelin e bodrumit në pjesën e Limak dhe asaj të ANP-se kontrollohet nga lexuesi i kartave. Duhet që kjo derë të mbyllet me celes dhe celesi të mbahet nga Sigurimi i ANP-se, duke qenë se përmes kësaj dërrë mund të ketë qasje deri të Kulla e Kontrollit. Pjesa e hapur anash dërrës, përmes të cilit depërtojnë kabllot duhet të mbyllet me ndonjë pengesë mekanike në mënyrë që të pamundesohet qasja e pautorizuar përmes asaj vrime.	LIMAK dhe ANSP janë në finalizim të nënshkrimit të MOU-s në lidhje me qasjen e dyfishtë në këtë dërrë. Kurse pjesa e hapur e dërrës që është verejtur gjatë inspektimit LIMAK ka bërë mbylljen e saj.	“CLOSED”
36	Zyret/Hapesirat	Gjatë vizitës u pa që ka një	LIMAK ka theksuar se kjo është	



		dhomë ku është parapare të lejohet pirja e duhanit e që është ngjitur me kuzhinën. Kjo hapësirë është e panëvojshme për këtë qëllim, kështu që duhet të konsiderohet si zyrë dhe të nderrohet destinimi i saj	pergjegjesi e ANSP	“CLOSED”
37	Zyret/Hapësirat	Zyra e asistentit/tës në korridor nuk ka paravan. U kerkua që kjo hapësirë të kufizohet përmes venies së një muri xhamash.	LIMAK ka theksuar se kjo është pergjegjesi e ANSP.	“CLOSED”
38	Zyret/Hapësirat	Dyert e daljeve emergjente nuk janë të markuara si duhet. Ka nga to që janë të shenjuara si dyer të daljeve emergjente (shenja Exit me sfond të gjelber), por që nuk janë të tilla. Asnjë derë nuk ka rezen për hapje të lehtë të derës në rast paniku (ang. panic bar). Nuk dihet nëse janë të pajisura me alarm, në rast të hapjes së tyre në menyre të pavullnëtshme. Poashtu, këto dyer kanë rezë nga ana e jashtme, që përgjithësisht nuk rekomandohet për këto lloje dyeresh. Dyert në përgjithësi kanë zbrastësi në pjesën e poshtme të tyre përmes të cilës depërton të nxehtë/të ftohtë, apo edhe brejtësit. Në dhomen e APP dera nuk ishte cilesore, shihej dritë përmes gomes izoluese, pra nuk ishte e puthitur sic duhet.	LIMAK ka bërë përmirsimet e nevojshme me këto rast.	“CLOSED”

39	Sigurimi	Sistemi i X-Ray duhet të vendoset në hyrje të objektit . Me këtë do të përmbushen standardet në fuqi të sigurisë për objekte të tilla vitale.	LIMAK ka theksuar se kjo është përgjegjesi e ANSP-se.	“CLOSED”
40	ATC-ACC-021 Qendra e kontrollit radarik	Dera e hyrjes në këtë sallë duket se i ka ndëprerësit për hapje të derës (nga brenda përmes shtypjes së butonit dhe nga jashtë përmes lexuesit të kartës RFID) të vendosur në anë të gabuara. Duhet të rilokohen këta ndëprerës, ose të ndërrohen krahët e dyerve.	ANSP dhe LIMAK janë pajtuar që të mos ketë ndryshime në këto pike .	“CLOSED”
41	Sigurimi	Dera e emergjencës në korridorin që të shpie në Kullë të kontrollit (pjesa lindore e ndërtesës) duket të jetë e tepërt, duke qenë se në objektin në përdhese tashme ka tri dyer emergjence. Duhet të shikohet mundësia që kjo derë të mbyllet me celes, kjo duke e ditur që Kulla e kontrollit e ka një derë të vetën të emergjencës.	ANSP dhe LIMAK janë pajtuar që kjo derë të mbyllet me celes dhe të mos shfrytëzohet si derë emergjente	“CLOSED”
42	Sigurimi	Duhet të vendoset një derë shtesë në mes korridorit lindor dhe Kullës së Kontrollit. Kjo derë do t’ua pamundesontë qasjen personelit të autorizuar për në ashensorin/shkallet e Kullës së Kontrollit.	LIMAK ka bërë realizimin e kësaj kërkesë duke vendosur derën në këto hapsire si dhe interfonin për qasje të kontrolluar	“CLOSED”
43	Ashensori	Ashensori kishte verejtjen “out of service” të aktivizuar.	LIMAK –ka sanuar alarmin e ashensorit	“CLOSED”

		Duhet të rregullohet ky problem.		
44	Ashensori	Duhet të ofrohen manualet e prodhuesit, pranimet teknike, si dhe të bëhet trajnimi i stafit për mirembajtje dhe operim.	Jane ofruar te gjitha manualet e ashensorit dhe LIMAK ka theksuar se jane ne gjendje te organizojn trajnimin bazik kurdo qe neve jemi te gatshem	“CLOSED”
45	Kulla e kontrollit	Duket se ka nje problem në lidhje me pamjen qe ofrohet nga kulla e kontrollit, kjo sidomos në drejtim të pjeses lindore, me saktë nuk shihen të gjitha pjeset e hapësirës manovruese sic kerkohet nga kontrata PPP, por edhe nga standardet për Sherbim të Kontrollit të Trafikut Ajror në Aeroport. Ekspertet e INECO-s deklaruan që një ekspert nga kjo kompani inxhinerike e ka bere matjen, mirepo duket qe ballkoni përreth Kulles se Kontrollit paraqet pengese në pamjen e Kontrollorit të Trafikut Ajror. Nëse edhe matjet precize qe do të zhvillohen në vijim e shpërfaqin këtë problem, atëhere do të paraqitet nevoja për ta thyer nje pjese të ballkonit në forme shumekendeshi përreth Kulles se Kontrollit, të paktën dy brinjët qe shohin në drejtim të verilindje/lindje dhe lindje/juglindje afersisht drejtimi 060 deri 120 ( <a href="#">Google Earth</a> ) në raport me Kullen e Kontrollit). Pamja në gjithe hapësirën manovruese kerkohet qoftë nga standardi FAA të cilit i është referuar PPP, apo standardi nderkombetar përmes ICAO, ICAO 2.	Fillimisht neve si ANSP kemi kerkuar qe te behet prerja e dy brinjeve te ballkonit por LIMAK ka theksuar se nje gje e tille mund te ndikoj qe te demtohet sistemi I drenazhimit dhe nuk garantonte qe ne te ardhmen e afert te mos kete problem.Gjithashtu prishej edhe harmonia e objektit te kullës.Ne nderkohe ne si ANSP kemi trajtuar kete problematike dhe kemi marre vendim qe ballkoni I kullës nuk do te preket, por do te lihet ashtu siq eshte.Prandaj kete pike ne si ANSP e konsiderojm te mbyllur.	“CLOSED”
46	Kulla e kontrollit	Tavani i Kulles së Kontrollit është në gjendje shumë të	LIMAK gjete kohesse inspektimit te komisionit te ANSP ka	

		keqe. Problemi me i madh duket të jetë prania e ujit gjithandej nëpër atë sipërfaqe. Vrimat për zbrazen e ujit duket se nuk janë në pikat me të ulta të kulmit, kështu që ka ujë të ndenjtur në afersi të atyre vrimave. Sipërfaqja e izolimit është e pangjitur me sipërfaqen e betonit të kulmit dhe në shume vende është e riparuar që tani. Kjo gjendje është absolutisht e papranueshme dhe nevojitet nderhyrje e menjehershme në menyre që objekti të mos pesojë dëme nga uji atmosferik.	theksuar se akoma nuk është finalizuar çatia e objektit të kullës .Ne nderkohe LIMAK ka bere finalizimin e izolimit të çatise se kullës .	“CLOSED”
47	Kulla e kontrollit	Pastrimi i dritareve (xhamave) në nivelin poshtë kabinës së Kullës së Kontrollit (niveli ku është dalja nga ashensori në katin e sipërm) duket se është i pamundur. Limak duhet të ofroje një zgjidhje për këtë problem, apo të ofroje opsionet se si e kanë parapare ata pastrimin e këtyre xhamave nga jashtë, kjo sidomos duke pasur parasysh që muret ku janë të vendosur këta xhama nuk janë pingul, por janë të venë në kënd që del jashtë objektit.	LIMAK dhe ANSP janë pajtuar se pastrimi i xhamave të nivelit të poshten në kulle do të përfshihet në MOU që parashihet të bëhet në mes ANSP dhe LIMAK.LIMAK dhe ANSP janë në finalizim të nëshkrimit të MOU-je në lidhje me këto çështje.	“CLOSED”
48	Kulla e kontrollit	Duhet të ketë se paku 4 “Obstacle Light” në kulm dhe duhet të përfordhen si duhet .Dera e qasjes për dalje në kulm duhet të nderrohet, sidhe kapaku për mbylljen e vrimave ku kalojnë kabllot duhet të përfordhet.	LIMAK ka theksuar se kjo është përgjegjësi totale e tyre në operim dhe mirëmbajtje.	“CLOSED”
49	Kulla e kontrollit	Të gjitha xhamat e krisura	LIMAK ka bere nderrimin e te	

		duhet të nderrohen,kurse xhamat që janë verejtur se jane njëstresor duhet të vendosen si dy shtresor (sikur xhamat tjera ne kullë)	gjitha xhamave te krisuar	“CLOSED”
50	Sigurimi	Objekti i Kulles së Kontrollit se bashku me zyrat në ndertësen përdhesë nuk janë të rrethuara me rrethojë, përvec në pjesen lindore. Në këtë menyrë sic është, objekti s'i plotëson kriteret e vena nga autoritetet që i rregullojn ceshtjet e sigurimit (ang. security) për certifikim(Ministria e Puneve të Brendshme)	LIMAK ka bere instalimin e rrethojes duke u bazuar ne standardet e MPB per objekte te tilla me rendesi vitale	“CLOSED”
51	Sigurimi	Rrethoja duhet të ketë portën e cila hapet në menyrë të dirigjuar.	LIMAK ka bere instalimin e portes te dirigjuar ne menyre manuale,kurse dirigjimi i portes ne menyre automatike nga larg LIMAK ka theksuar se nje gje e tille eshte pergjegjesi e ANSP-se	“CLOSED”
52	Sigurimi	Duhet të ndertohet një kthinë (shtëpize) brenda rrethojes (afër portës së kerkuar të jashtme), në menyre qe personeli i sigurimit nga aty të bëjë hapjen dhe mbylljen e portës (në forme të dirigjuar)si dhe të identifikoj personelin dhe palet e tjera	LIMAK ka theksuar se nuk do te beje ndertimin e kesaj kthine dhe se kjo eshte pergjegjesi e ANSP-se	“CLOSED”
53	Panelet elektrik të UPS-it në dhomat EQ-ATC-022,ATC-ACC-021,dhe ATC-M/A (meteo Ais	Të gjithë panelat elektrik fundor në dhomat e cekura duhet të pajisjen me siguresa diferenciale.Seciles prizë (me UPS) në keto hapsira duhet të i sigurohet një sigures me mbrojtje diferenciale në panel elektrik të UPS-it.	LIMAK ka theksuar se kjo eshte pergjegjesi e ANSP .	“CLOSED”
54	Drita sinjalizuese /rrotulluese mbi TWR	Drita sinjalizuese rrotulluese mbi TWR duhet të përforcohet dhe të ipen rezultatët e testimeve.Gjithashtu duhet të ipen manualet e prodhuesit .	LIMAK ka theksuar se kjo eshte pergjegjesi totale e tyre ne operim dhe mirembajtje	“CLOSED”
55	CCTV /Met	Duke pasë parasysh se zyret	LIMAK ka bere dorezimin e	

		<p>e personelit meteorologjik janë të pozicionuara në atë pjesë që, pjesa e pistës ka 35 nuk mund të shihet për shkak të objektit të kullës dhe të terminalit. Si nevojë operative duhet modeomos të shihet ajo pjesë, prandaj kërkohej që të na mundësohet qasja në ndonjë kamerë në terminal e cila është e orientuar ka pista 35. Nëse nuk ka ndonjë kamerë të orientuar në atë drejtim, atëherë kërkojmë që një e tillë të instalohet dhe të futet në sistemin tonë të CCTV.</p>	<p>kameras tek ANSP-ja dhe ka theksuar se do të asistoj në instalimin e saj që parashihet të bëhet në objektin e kullës, por asesi nuk ka mundësi të bëjë instalimin e saj në pjesën e terminalit.</p>	<p>“CLOSED”</p>
56	<p>Dokumentat mbi llogaritjet (dokumente përcjellese të “As Build”)</p>	<p>Duhet të sigurohen edhe pjesa tekstuale e projektit (pjesa grafike është dorëzuar) si: përshkrimi i materialit të kullës dhe objekteve përcjellese, llogaritjet e elektrike të transformatorit, kablove (rrymat e lidhjeve të shkurtra, rrymat nominale, rrymat e tensionit etj.), llogaritjet për sistemin HVAC etj.</p>	<p>LIMAK ka dorëzuar të gjitha materialet e nevojshme në lidhje me këtë çështje.</p>	<p>“CLOSED”</p>